



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No	738
Nr. i fag./Br.sh./No. pg.	738
Data/Datum/Date	12 / 7 / 21
RAHOVEC / ORAHOVAC	

PROCESVERBALI NGA TAKIMI I PARË PUBLIK ME QYTETARË I KRYETARIT TË KOMUNËS

Nga takimi publik me qytetarë për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2021, mbajtur, më 28.06.2021, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00.

Në bazë të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23, 24 dhe 25 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, kryetari i komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi edhe në vitin 2021 ka vazhduar me takime publike, kështu duke rritur nivelin e bashkëpunimit me qytetarë.

Kryetari i komunës së Rahovecit, z. Smajl Latifi, në hapjen e këtij takimi, ju uroj mirë se ardhje gjithë të pranishmëve duke theksuar se ky është takimi me qytetarë për periudhën e parë të vitit 2021, ku fillimisht prezantoi rendin e ditës: Raporti gjashtë (6) mujor i vitit 2021, dhe Informatë rreth aktiviteteve dhe projekteve në komunën e Rahovecit si dhe në pika të shkurtëra sukseset, të arriturat dhe sfidat e gjashtë (6) mujorit të vitit 2021, ndërsa pjesa tjetër e takimit ishte në diskutim me qytetarët, pyetjet e tyre, komentet dhe interesimet e tjera.

Më datë 11/6/2021 është publikuar njoftimi në ueb faqen e komunës për mbajtjen e takimit me qytetar për punën gjashtë (6) mujore për vitin 2021, njoftimin mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2021/06/Njoftim-nga-kryetari-i-komunes-Smajl-Latifi-per-mbajtjen-e-takimit-te-pare-publik-me-qytetare-per-punen-ne-gjashte-6-mujorin-e-vitit-2021.pdf>

Po ashtu, raporti gjashtë mujor i punës së Qeverisë Komunale është publikuar me datë: 21.6.2021 dhe mund ta gjeni në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2021/06/Raporti-i-6-Mujor-i-Kryetarit-te-Komunes.pdf>

Ndërsa, më datë 28.6.2021 është mbajtur takimi i parë publik me qytetarë për punën gjashtë (6) mujore për vitin 2021, në këtë vjegëz mund ta gjeni lajmin: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/neës/kryetari-latifi-mbajti-takimin-e-pare-publik-me-qytetare-per-punen-ne-gjashte-6-mujorin-e-vitit-2021/>

Të pranishëm në këtë takim ishin: Smajl Latifi, kryetar i komunës, z. Fatmir Iska, nënkryetar, drejtor të drejtorive, anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqësues të OJQ-ve, qytetarë, kryetarë të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, zyrtarë komunal, përfaqësues i OSBE-së Sead Raba si dhe përfaqësues të medimeve.

Një përmbledhje e pyetjeve të qytetarëve është dhënë në vijim. Të gjitha pyetjeve iu janë përgjigjur, varësisht nga natyra e pyetjeve, Kryetari dhe drejtorët përkatës komunal.

Pvetjet dhe komentet e qytetarëve:

Skender Krasniqi, kryetar i fshatit Opterushë: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. E vlerësoj lartë punën e deritanishme të kryetarit të komunës, z. Smajl Latifi, mirëpo kemi një shqetësim rreth plaçkitjeve të shtëpive që po bëhen në lokalitetin tonë.

Përgjigja:

Smajl Latifi, kryetar i komunës: I bashkohem thirrjes së Skënderit andaj i bëj thirrje organeve kompetente në këtë rast Policisë së Kosovës që të ndërmarrin masa rreth kësaj çështjeje.

Ali Morina, qytetarë i fshatit Ratkoc: Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje rreth projektit për mirëmbajtjen e rrugëve fushore se a do të vazhdojë edhe më tutje si projekt, po ashtu kërkoi që të angazhoheni edhe në trajtimin e përroskave. Përgjigje ka dhënë Kryetari i Komunës dhe Drejtori i DBPRZH, Berat Duraku .

Nasip Krasniqi, drejtor i shkollës fillore "Nesimi Elshani": Përhëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë fillimisht dua të falënderoj kryetarin për përfshirjen e të gjithë vendbanimeve të komunës në projekte të ndryshme. Ndërsa kam një pyetje se kur do të bëhet rrethimi i oborrit të shkollës fillore "Nesimi Elshani" në fshatin Nagac.

Përgjigjja:

Rumir Zhuniqi, drejtor i DUPMM: Pas përfundimit të mbjellës së drunjve dekorativ do të bëhet edhe rrethimi i oborrit të shkollës.

Murat Kryeziu, kryetar i fshatit Xërxë: Nuk kanë përfunduar punët rreth kullimit të ujrave atmosferik, ndriçimit publik, kanalizimit në fshatin Xërxë.

Përgjigjja:

Berat Duraku, drejtor i DBPZHR: Si projekt ka përfunduar me sukses mirëpo aty ka probleme pronësore ashtu siç jeni në dijeni edhe ju kryetar (Murat Kryeziu).

Xhafer Gashi, kryetar i fshatit Sopniq: E vlersoj lartë punën e deritanishme të kryetarit të komunës, z. Smajl Latifi, ndërsa kam një pyetje për drejtorin e Arsimit se a do të intervenohet në rregullimin e toaleteve në shkollën fillore Sopniq.

Përgjigjja:

Avni Morina, drejtor i DKA-së: Është duke vazhduar riparimi i shkollës fillore në Sopniq, ku përfshihet edhe rregullimi i toaleteve të shkollës në Sopniq.

Teki Mustafa, kryetar i lagjes II-Rahovec: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Kam dy shqetësime, a ka barnatore shëndetësore kujdestare në Rahovec? Ndërsa si shqetësim tjetër i lokalitetit tonë është problemi me qentë endacak.

Përgjigjja:

Smajl Latifi, kryetar i komunës: Barnatore shëndetësore kujdestare nuk kemi në Rahovec. Sa i përket shqetësimit; për qentë endacak ne si komunë kemi nënshkruar një marrëveshje për trajtimin e qenve endacak andaj do të vazhdojmë me i kushtua kujdes kësaj pune.

Xhemajli Kastrati, kryetar i fshatit Drenoc: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Po ju shpreh një shqetësim nga banorët e këtij lokaliteti se në ambulanten e fshatit tonë nuk ka mjek, mendoj që është nevojë emergjente që kjo çështje të ketë zgjidhje.

Përgjigjja:

Samir Mustafa, Drejtor DSHPS-së: Ne si drejtori brenda kompetencave ligjore kemi hapur konkurs për dy mjek andaj shumë shpejt sipas procedurave do të angazhohen.

Mirsad Qehaja, kryetar i fshatit Retijë e Poshtme: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Nuk po mirëmbahen rrugët deri të kufiri administrativ si dhe kur do të bëhet rregullimi i fushës sportive?

Përgjigjja:

Përparim Krasniqi, drejtor i DSHP: Ne si drejtori kemi kontratë për mirëmbajtjen e rrugëve e cila po vazhdon të implementohet me sukses. Ne si drejtori këtë kërkesë do ta përcjellim dhe te organi mbikëqyrës do të merret me këtë çështje.

Përgjigjja:

Bjondina Kleqka, drejtoreshë e DKRS-së: Përgjigjet në pyetjen e z. Mirsad Qehaja për rregullimin e fushës sportive: Si projekt është në procedurë të prokurimit dhe pas përfundimit të procedurës do të filloj zbatimin e projektit.

Po ashtu, gjatë takimit, diskutime për punët, të arriturat dhe sfidat gjatë gjashtë (6) mujorit të vitit 2021, patën drejtorët e disa drejtorive për çështjet e bujqësisë, zhvillimit ekonomik, kulturës dhe sportit, infrastrukturë, arsim dhe urbanizëm.

Takimi u zhvillua nga kryetari i komunës, z. Smajl Latifi dhe drejtorët: Përparim Krasniqi, drejtor i DSHP-së, Berat Duraku, drejtor i DBPZHR, Samir Mustafa, drejtor i DSHPS, Bjondina Kleqka, drejtoreshë e DKRS, Rumir Zhuniqi, drejtor i DUPMM, Avni Morina, drejtor i DKA-së.

Pas përfundimit të leximit të të gjitha pyetjeve dhe marrjes së atyre që kanë kërkuar fjalën, kryetari i komunës inkurajoi qytetarët se çfarëdo pyetje, sugjerime apo dhe komente që prekin interesat e tyre publike, mund t'i adresojnë në komunë ku dhe me kohë do të marrin përgjigje nga drejtoritë dhe personat kompetent.

Takimi përfundoi në ora 12:45 minuta.

Smajl Latifi



Burda
Qëndresa Duraku

Zyra e kryetarit

Komuna e Rahovecit

Adresa : Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n,21000,Rahovec –Kosovës Tel :0382004534 Email : komuna.rahovec@rks-gov.net